



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



# KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA

**Raporti Vjetor**

**2007**

**drejtuar**

## KUVENDIT TË KOSOVËS

**shkurt 2008**

**Telefoni: 038 245 031**  
**Telefaksi: 038 245 034**  
**ueb faqja: [www.imc-ko.org](http://www.imc-ko.org)**  
**E-mail: [info@imc-ko.org](mailto:info@imc-ko.org)**

## PARATHËNIE

Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media, në bazë të një drafti të përgatitur nga Shefja Ekzekutive e Zyrës së KPM-së, është i nderuar t'i dorëzoj Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin e dytë vjetor të saj, siç kërkohet nga Neni 3.8 i Ligjit Nr. 02/L-15 mbi Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim.

Komisioni i Pavarur për Media, si rregullator i pavarur për rregullimin e transmetimit në Kosovë, është themeluar më Ligjin e Kuvendit të Kosovës Nr. 02/L-15, udhëhiqet nga ligji, Politikat e saj të Transmetimit, duke u bazuar në praktikat më të mira Evropiane të të drejtave të njeriut, dhe nga interesi publik. KPM-ja rregullon Spektrin Frekuencor të Transmetimit në Kosovë, si dhe licencën transmetuesit publik dhe privat. Vendimet e saj që ndikojnë te subjektet transmetuese mund të apelojnë te Bordi i Ankesave për Media. Bordi vepron në mënyrë të pavarur dhe vendimet e tij janë përfundimtare, por mund të jenë subjekt i shqyrtimeve procedurale nga Gjykata Supreme e Kosovës.

### Fusha e Transmetimit në Kosovë

Si rezultat i punës së Komisionit të Pavarur për Media, ndërtuar në përpjekjet e Komisionerit të Përkohshëm për Media, tani në Kosovë janë 114 subjekte transmetuese të licencuara nga KPM-ja. Licencimi i subjekteve transmetuese ekzistuese sipas zonës së mbulimit ndahet në 4 kategori:

- Subjekte transmetuese me mbulim mbarë-kosovarë;
- Subjekte transmetuese me mbulim lokal;
- Subjekte transmetuese me fuqi të ulët transmetimi

Ndarja sipas kategorive:

- 3 televizione me mbulim mbarë-kosovar (1 televizion publik, 2 televizione private)
- 4 radiostacione me mbulim mbarë-kosovar (2 radio publike, 2 radio private)
- 15 televizione me mbulim lokal
- 73 radiostacione me mbulim lokal
- 3 televizione me fuqi të ulët transmetimi
- 16 radiostacione me fuqi të ulët transmetimi

Emetimi i programit sipas gjuhës kryesore:

- 70 subjekte transmetuese transmetojnë në gjuhën shqipe si gjuhë kryesore, përfshirë transmetuesin publik (RTK)
- 35 subjekte transmetuese transmetojnë në gjuhën serbe si gjuhë kryesore
- 3 subjekte transmetuese në gjuhën boshnjake
- 3 subjekte transmetuese në gjuhën turke
- 2 subjekte transmetuese në gjuhën gorane dhe
- 1 subjekt transmetues në gjuhën rome

Shpërndarja e subjekteve transmetuese sipas ndarjes regjionale në Kosovë:

- Gjilani: 34 subjekte transmetuese;
- Mitrovica: 20 subjekte transmetuese;
- Peja: 14 subjekte transmetuese;
- Prishtina: 26 subjekte transmetuese;
- Prizreni: 20 subjekte transmetuese.

Një e treta (1/3) e subjekteve transmetuese janë stacione që transmetojnë në gjuhën serbe dhe afër 30 % e të gjitha subjekteve transmetuese ofrojnë program në së paku dy gjuhë që fliten në Kosovë. Prandaj një prej qëllimeve të KPM-së është që në Kosovë të ketë një shumëllojshmëri të mediave për secilin komunitet, duke i ofruar atyre qasje në informim në gjuhën e tyre përkatëse.

Aktualisht në territorin e Kosovës në shfrytëzim janë 208 kanale frekuencore ku përfshihen:

- 52 TV kanale
- 156 FM kanale

Frekuencat janë të ndara për pesë lloj shërbimesh ku:

37 kanale frekuencore përdoren për mbulim nacional (18 janë TV kanale, 16 FM dhe 3 lokale);

53 kanale frekuencore përdoren nga KFOR-i (11 janë TV kanale dhe 42 FM kanale);

92 kanale frekuencore lokale (17 janë TV kanale dhe 75 janë FM kanale);

22 kanale frekuencore me fuqi të vogla (6 janë TV kanale dhe 16 FM kanale); dhe 4 kanale frekuencore Internacionale FM (BBC, RFI, DW, VOA).

Të gjitha këto frekuenca përdoren nga pesë (5) lloje të mediave:

- 3 TV + 4 FM Media Nacionale
- 11 TV + 42 FM media te KFOR-it
- 17 TV + 75 FM media Lokale
- 3 TV + 16 FM media me fuqi të vogël
- 4 FM Internacionale

#### Pasqyra e Raportit

Ky raport ofron një pasqyrë të punës gjatë vitit 2007 të të tre organeve që përbëjnë Komisionin e Pavarur për Media, Këshillit, Bordit të Ankesave për Media dhe Zyrës së Shefes Ekzekutive.

Për interes të transparencës, raporti gjithashtu paraqet planet e KPM-së për vitin 2008, kështu që Kuvendi i Republikës së Kosovës, opinioni publik dhe subjektet transmetuese, dhe të tjerët që operojnë në fushën e transmetimit, mund të informohen për aktivitetet e planifikuara për vitin aktual. Kjo përfshin:

1. Fillimin e procesit të ri licencimit të të gjitha subjekteve transmetuese ashtu siç kërkohet me ligjin për KPM-në

2. Licencimin e operatorëve kabllor dhe ofruesve të shërbimeve programore përmes kabllor
3. Miratimi i rregullores për subjektet transmetuese mbi mbrojtjen e të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore
4. Përcaktimi dhe implementimi i tarifave vjetore të licencave
5. Hartimi i strategjisë për planin frekuencor digjital të Kosovës

Në një instancë, raporti shkon përtej vitit 2007. Në kapitullin mbi Bordin e Ankesave për Media, ekzekutimi i vendimeve të saja, ky raport ofron një kronologji të plotë të ngjarjeve – duke filluar prej vitit 2005 dhe duke përfunduar në vitin 2008 – që shpie te mbyllja e një subjekti transmetuar ilegal dhe hapja e një tenderi të ri për të licencuar një subjekt të ri transmetues për zonën e njëjtë. Kjo ka qenë e domosdoshme për të ofruar shpjegim të plotë të veprimit të KPM-së. KPM-ja duhet të jetë rigorozë në zbatimin e ligjit dhe promovim të zbatimit të ligjit në transmetim, por i ka marrë këto vendime të pashmangshme dhe të domosdoshme pas disa vjetësh të dhënies së mundësisë për subjektin transmetues që të silllet në pajtueshmëri me licencën dhe vendimet e KPM-së dhe Bordit të Ankesave për Media.

#### Nevoja për Këshill të kompletuar të KPM-së

Që nga gushti i vitit 2007, Këshilli i KPM-së nuk është në përbërje të plotë. Mandatet fillestare të dy anëtarëve vendorë nga shoqëria civile kanë përfunduar. KPM-ja e ka përfunduar procesin për nominimet e reja brenda afateve kohore të parapara me ligj, dhe i ka paraqitur ato në Kuvend. Procedurat parlamentare, megjithatë, nuk janë kompletuar.

Kjo ka paraqitur pengesë për funksionimin e Këshillit, jo vetëm në kuptim të pamundësisë së tij për të zgjedhur kryesuesin ri. KPM-ja shpreh shpresën, të dhënë në planin ambicioz për vitin 2008, se këto procedura tani do të mund të kompletohen më shpejt.

#### Konkludim

Këshilli i KPM-së zyrtarisht dëshiron të potencojë vlerësimin e tij të lartë për punën e Shefes Ekzekutive, znj. Naile Selimaj – Krasniqi, dhe personelit të Zyrës së saj.

Këshilli i KPM-së dëshiron të zgjeroj falemnderimin e tij edhe për Bordin e Ankesave për Media, të udhëhequr nga Presidenti i tij, Prof. Dr. Wolfgang Benedek, për punën e tij.

Këshilli i KPM-së dëshiron të falemnderoj ndihmën e rëndësishme që ka marrë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, dhe posaçërisht nga Këshilltari i Lartë Ligjor, Dr Charles Ehrlich.

***Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media***

***Shkurt, 2008***

## **BAZA LIGJORE E KPM-së**

Më 21 prill 2005, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin nr. 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, i cili ishte shpallur nga PSSP-ja më 8 korrik 2005 me rregulloren Nr. 2005/34. **Ligji për KPM-në** ka hyrë në fuqi më 8 shtator 2005.

Sipas Nenit 3.8. të Ligjit për KPM-në, Këshilli i KPM-së përgatit dhe i paraqet Kuvendit të Kosovës, brenda dy muajve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, një raport vjetor duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit dhe objektivat e projektimit për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik.

## **KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) është rregullator i pavarur për rregullimin e transmetimit në Kosovë. Qëllimi i një rregullatori për transmetim është të ndajë një burim të kufizuar – brezin frekuencor – në mënyrë të drejtë dhe të hapur për t'iu shërbyer më së miri të gjithë qytetarëve në Kosovë. KPM-ja promovon standarde etike dhe teknike për mediat transmetuese në Kosovë dhe zbaton një grup rregulloresh që i mban subjektet lokale transmetuese në nivel me standardet evropiane të profesionalizmit dhe paanësisë në mbulimin e lajmeve të tyre. Përmes administrimit të planit të saj frekuencor të transmetimit, KPM-ja gjithashtu përpiqet të jetë e paanshme në konkurrimin në mes të subjekteve transmetuese. Aktivitetet e KPM-së përfshijnë monitorimin e mbulimit e ngjarjeve aktuale të transmetuara, komentimet rreth legjislacionit që ka të bëjë me media, vlerësimin e ankesave dhe zbatimin e rregulloreve dhe kushteve të licencave të lëshuara nga KPM-ja.

KPM-ja inkurajon zhvillim profesional dhe financiarisht të sigurt të mediave publike dhe private. Duhet të sigurojë që mediat respektojnë të drejtat e njeriut për shprehje të lirë dhe shumëllojshmëri të opinioneve, për paanësi dhe saktësi jo vetëm në programet informative por edhe në reklama. KPM-ja gjithashtu siguron se mediat mbrojnë interesat dhe ndjeshmërinë e fëmijëve, të drejtat e pakicave dhe kulturave të ndryshme që e bëjnë Kosovën një vend unik në Evropë. KPM-ja e bën këtë në mënyrë transparente dhe konsultative, me qëllim që të sigurojë respekt si nga publiku ashtu edhe nga subjektet transmetuese.

Komisioni i Pavarur për Media përbëhet nga tre trupa të veçantë:

- Këshilli
- Zyra e Shefit Ekzekutiv, dhe
- Bordi i Ankesave për Media

## **KËSHILLI I KPM-së**

Këshilli është organ vendim-marrës i KPM-së. Përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve prej të cilëve pesë (5) janë anëtarë vendor ndërsa dy (2) janë anëtarë ndërkombëtarë.. Katër anëtarët vendor nominohen nga Shoqëria Civile dhe një nga Kuvendi i Kosovës. Të gjithë këta emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Dy anëtarët ndërkombëtar emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP).

Këshilli drejton Komisionin lidhur me çështjet strategjike që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit të KPM-së. Këshilli nxjerr akte, instruksione, politika dhe detyra që janë të nevojshme për funksionimin efektiv të Komisionit të Pavarur për Media. Bazuar në rekomandimet nga Zyra e Shefit Ekzekutiv, Këshilli vendos për dhënien e licencave dhe bënë përtëritjen e tyre, duke ju dhënë subjekteve transmetuese të drejtën për shfrytëzim të frekuencës në Spektrin Frekuencor të Transmetimit. Për shkelje të rregulloreve të KPM-së dhe ligjeve dhe rregulloreve relevante apo shkelje të kushteve të licencës nga ana e subjekteve transmetues të licencuara nga KPM, Këshilli ka të drejtën edhe të shqiptojë sanksione.

Për periudhën për të cilën raportohet, respektivisht nga muaji gusht 2007, Këshilli i KPM-së ka qenë në këtë përbërje:

Milena Djeric – zëvendës kryesuese  
Filloreta Bytyçi - anëtare  
Adil Pireva - anëtar  
Karol JakuboJicz- anëtar  
Sandra Basic Hrvatin – anëtare

Ndërsa, në periudhën janar - gusht 2007, Këshilli i KPM-së përbëhej nga:

Isuf Berisha – kryetar  
Milena Djeric – zëvendës kryetare  
Filloreta Bytyçi - anëtare  
Iilir Dugolli - anëtar  
Adil Pireva - anëtar  
Sandra Basic Hrvatin - anëtare  
Katrín Nyman Metcalf – anëtare

### *Mandati i Anëtarëve të Këshillit*

Sipas Nenit 5 të Ligjit të KPM-së:

*“a. mandati fillestar i njërit prej anëtari ndërkombëtar është tetëmbëdhjetë (18) muaj; b. mandati fillestar i anëtarit tjetër ndërkombëtar është dymbëdhjetë (12) muaj;”*

*“Si përjashtim nga neni 4.2 (a) i këtij ligji, mandati fillestar i dy (2) anëtarëve të*

*Këshillit nga shoqëria civile është një (1) vit për secilin, që duhet të zgjidhet me short të tërhequr nga Komisioneri i Përkohshëm i Mediave në një takim publik”*

Isuf Berisha dhe Ilir Dugolli, anëtarë vendorë të nominuar nga Shoqëria Civile, kanë pasur mandat një vjeçar të caktuar me short sipas ligjit, e po ashtu edhe anëtarja ndërkombëtare Katrin Nyman Metcalf, ka pasur mandat një vjeçar. Mandatet e tyre kanë përfunduar më 28 gusht 2007.

#### *Emërimet e anëtarëve të rinj të Këshillit të KPM-së*

Në pajtim me Nenin 4.4 b të Ligjit të KPM-së

*“Inicimin e procedurës për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit nga shoqëria civile e bën Shefi Ekzekutiv, duke publikuar një ftesë jo më vonë se tre (3) muaj para skadimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit nga shoqëria civile”.*

Shefja Ekzekutive ka iniciuar procedurën për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit më 10 prill 2007, procedurë e cila ka përfunduar më 9 maj 2007. Procesi ka qenë i hapur dhe pas përfundimit të procesit emrat e të nominuarve janë bërë publik përmes një konference për shtyp të organizuar nga KPM dhe e njëjta është publikuar në ueb faqen e KPM-së.

Më 14 qershor 2007, KPM-ja ka dërguar në Kuvendin e Kosovës emrat e katër kandidatëve për dy poste të anëtarëve vendorë të Këshillit. Më 17 shtator 2007 Kuvendi i Kosovës ka themeluar Komisionin Ad-Hoc siç përcaktohet me Nenin 4.4 (e) për të bërë zgjedhjen e dy anëtarëve. Ky Komision është takuar më 9 nëntor 2007. Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur të mbajë seancën për emërimin e dy anëtarëve të rinj të Këshillit të KPM-së.

Pas muajit gusht 2007, në mungesë të dy anëtarëve, Këshilli i KPM-së nuk pati kuorum të anëtarëve vendorë për të mbajtur takimet e veta që është shumë qenësore për punën e Këshillit pasi që jo gjithmonë mund të sigurohej pjesëmarrja e anëtarëve ndërkombëtarë. Në këtë fazë të zhvillimit të KPM-së janë paraqitur nevoja që të ketë takime më të shpeshta, e jo së paku në çdo tre muaj siç përcaktohet me ligj, me qëllim të kompletimit të legjislacionit dytësor.

Në pajtim me Nenin 4.2 të Ligjit të KPM-së,

*“Anëtarët ndërkombëtarë të Këshillit emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP)”.*

PSSP ka emëruar Dr. Karol Jakubowicz si anëtar të dytë ndërkombëtar të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media. z. Jakubowicz ka filluar mandatin me 28 gusht 2007, dhe mandati i tij do të zgjasë deri më 28 gusht 2008.

*Karol Jakubowicz, Ph.D., deri vonë ka qenë Drejtor në Departamentin për Strategji dhe Analiza në Këshillin Kombëtar të Transmetimit në Poloni, autoriteti rregullativ i transmetimit, dhe Kryesues i Komisionit Drejtues mbi Mediat dhe Shërbimet e reja të Komunikimit në Këshillin e Evropës. Për shumë vite ai ka punuar si gazetar dhe në ekzekutivin e shtypit, radios dhe televizionit Polak. Ai ka qenë Nënkyetar në Radio Televizionin Polak; Kryesues, Bordi Mbikëqyrës, Televizioni Polak dhe Kryesues i*

Zhvillime dhe Planifikime Strategjike në Televizionin Polak. Ai ka qenë aktiv në Këshillin e Evropës, pjesërisht si ish Kryesues i Komisionit të Ekspertëve mbi Koncentrimin dhe Pluralizmin e Mediave, Kryesues i Komisionit Drejtues në Televizionin pa kufij.

Më zgjidhjen e statusit politik të Kosovës, numri i anëtarëve të Këshillit mbetet i njëjtë, shtatë (7), prej të cilëve dy anëtarët ndërkombëtarë do të zëvendësohen më anëtarë vendorë të emëruar sipas procedurave të parapara në Nenin 4.4 të këtij Ligji.

## **PUNA E KËSHILLIT GJATË VITIT 2007**

### **Licencimi i radios lokale në gjuhën romë në Prizren**

Duke marrë parasysh rëndësinë e sigurimit të një mundësie për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë që të kenë qasje në transmetim në gjuhët e tyre, në vitin 2007, Këshilli i KPM-së ka vendosur të bëjë një përjashtim në mënyrë që të pranojë aplikacione të reja për një radio stacion në gjuhën romë për qytetin e Prizrenit. Tenderi është hapur më 5 shkurt 2007 dhe ka qenë i hapur për 30 ditë, respektivisht deri më 5 mars 2007.

Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media ka përcaktuar kriteret e vlerësimit të aplikacioneve duke i radhitur faktorët kryesor për kualifikimin e kandidatëve si në vijim:

- Formati dhe skema programore e propozuar, duke marrë parasysh kërkesën për atë shërbim;
- Sasia e programit lokal të prodhuar;
- Paraqitja e një plani të qartë dhe praktik për organizimin dhe mbajtjen e një radio stacioni të angazhuar për program dhe shërbim publik për komunitetin rom;
- Aftësia profesionale për të themeluar dhe menaxhuar një stacion profesional transmetues, dhe aftësia e demonstruar për të financuar një stacion të tillë; dhe
- Pajtueshmëria e plotë me rregullën e përgjithshme të aplikueshme të KPM-së mbi kualifikimet për një licencë.

Pas njoftimit publik lidhur me tenderimin e frekuencës për radio lokale në Prizren, në zyrën e KPM-së janë paraqitur dy kandidatë të interesuar për këtë frekuencë. Vlerësimet e aplikacioneve janë bërë nga Divizioni i Licencimit, më pas janë shqyrtuar edhe nga një panel prej tre anëtarëve të Këshillit të KPM-së. Në Takimin e Këshillit të KPM-së, të mbajtur më 2 prill 2007, është marrë vendim për kandidatin më të kualifikuar për radiostacion në gjuhën romë. Kandidati tjetër, me të drejtë ankese është ankuar brenda afatit të caktuar në vendimin e Këshillit të KPM-së, kështu që rasti ka kaluar para Bordit të Ankesave për Media i cili pas shqyrtimit të ankesës e refuzoi atë në mungesë të fakteve të ofruara nga pala ankuese. Kandidati që u kualifikua për licencë të KPM-së, Radio Romano Avazi zyrtarisht filloi transmetimin e programit në nëntor 2007.

## **AKTET NËNLIGJORE TË MIRATUARA GJATË VITIT 2007**

Këshilli i KPM-së i ka miratuar këto akte nënligjore gjatë viti 2007\*:

1. CIMC – 2007 - 01 - Vendimi për Nivelin, Mënyrën e përcaktimit të pagesës së taksës për Licencë për radio dhe televizion.

---

\* Shtojca 1 Aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli I KPM-së.



2. CIMC – 2007 04 – Rregulloren e Distribuimit Kabllor te programeve radio televizive ne Kosovë
3. CIMC – 2007 05 – Vendimi për nivelin dhe mënyrën e përcaktimit te pagesës se taksës për Licence për Operatorët Kabllor dhe Ofruesit e Shërbimeve Përmes Kabllor.
4. CIMC – 2007 06 – Rregulla për Reklamim për Subjektet Transmetuese

Neni 3.14 I Ligjit të KPM-së përcakton se:

*“në çdo rast kur Këshilli planifikon të nxjerr një akt të veçantë, përkatësisht rregulloren me të cilën do të rregullonte raporte të caktuara, është i obliguar që aktet e tilla t’ua vërë në dispozicion një spektri të gjerë subjektësh. Publiku dhe palët e interesuara duhet të kenë jo më pak se 14 ditë në dispozicion për të komentuar draft-aktin. Personeli i Komisionit është i detyruar t’i marrë parasysh mendimet e publikut mbi aktet e propozuara.”*

Gjatë hartimit të këtyre akteve nënligjore, KPM ka vepruar në pajtueshmëri të plotë me këtë dispozitë ligjore. Për më tepër, para miratimit të Vendimit CIMC – 2007 – 01 “Vendimi për Nivelin, Mënyrën e Përcaktimit të Pagesës së Taksës për Licencë për Radio dhe Televizion” KPM ka organizuar edhe dëgjim publik me subjektet transmetuese. Ky dëgjim publik është mbajtur në Prishtinë më 15 mars 2007.

#### Vendimet Sanksionuese të Këshillit të KPM-së.

Në bazë të rekomandimeve të Zyrës së Shefit Ekzekutiv, Këshilli i KPM-së ka nxjerrë vendime sanksionuese për disa subjekteve transmetuese si në vijim;

**Ankesa me numër 2007/01**, për shkak të shkeljes së vendimit të Këshillit të KPM-së, Këshilli ka lëshuar vendim me të cilin ka caktuar gjobën prej 1000 euro për subjektin transmetues. Ky subjekt transmetues nuk është ankuar ndaj vendimit të Këshillit të KPM-së dhe nuk ka paguar gjobën.

**Ankesa me numër 2007/03**, Këshilli i KPM-së ka lëshuar vendim me të cilin urdhëroi subjektin transmetues që të kthehet me transmetim në kanal 47, si dhe gjobiti subjektin transmetues me 500 euro.

**Ankesa me numër 2007/01&2007/03**, për shkak të shkeljeve të dy vendimeve të mëparshme të Këshillit të KPM-së, për këto shkelje Këshilli vendosi që subjektin transmetues ti pezulloj licencën për periudhën kohore prej tre muajve. Subjekti transmetues nuk është ankuar ndaj vendimit të Këshillit në Bordin e Ankesave për Media dhe vendimi është ekzekutuar.

**Ankesa me numër 2007/07**, Këshilli i KPM-së ka lëshuar një vendim me të cilin ka gjobitur subjektin transmetues me 500 euro, Pala Ankuese është Ankuar në Bordin e Mediave për Ankesa.

**Ankesa me numër 2007/14**, subjekti transmetues ka shkelur vendimin e Këshillit të KPM-së të mbështetur edhe nga Bordi i Ankesave për Media. Për shkak të shkeljes të

vendimit të mëparshme të KPM-së, Këshilli i Këshilli i KPM-së vendosi që subjekti transmetues t'i pezullohet licenca për periudhën kohore prej tre muajve dhe e urdhëroj që të filloj të transmetoj nga vendi i licencuar si dhe nëse nuk kthehet në vendin e licencuar deri kur ky vendim të hynë në fuqi automatikisht licenca do t'i revokohet.

**Ankesa me numër 2007/15**, Këshilli i KPM-së ka lëshuar vendim me të cilin ka caktuar gjobën prej 1000 euro ndaj subjektit transmetues. Pala Ankuese është Ankuar ndaj këtij vendimi të Këshillit të KPM-së në Bordin e Ankesave për Media.

## **ROLI I KËSHILLIT TË KPM-SË NË KOMISIONIN AD HOC PËR BORDIN E**

### **RTK**

Me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor që del nga Neni 23.c, të Ligjit të RTK-së, më 16 shkurt 2007 në Zyrën e Komisionit të Pavarur për Media, me ftesë të Këshillit të KPM-së, është mbajtur takimi i parë konstituiv i Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për Bordin e transmetuesit publik, Radio Televizionit të Kosovës.

Komisioni Ad Hoc përbëhej nga 7 anëtarë: z. Besim Bokshi, nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës i cili njëherësh ishte edhe Kryesues i këtij Komisioni, z. Isuf Berisha, znj. Milena Djeric dhe z. Ilir Dugolli nga Këshilli i KPM-së dhe znj. Vjosa Dobruna, z. Milazim Krasniqi dhe znj. Snezana Karadjic nga Bordi aktual i RTK-së.

Në mbledhjen e tij të parë më 16 shkurt 2008, Komisioni Ad Hoc shqyrtoi kriteret e përcaktuara me ligj për nominimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së, funksionet dhe përgjegjësitë e Bordit dhe vendosi që KPM-ja të bëjë ftesën publike për propozime, e cila do të zgjaste nga 19 shkurt 2007 deri më 19 mars 2007. KPM shpalli ftesën publike për nominime në mediat elektronike dhe ato të shkruara, si dhe në ueb faqen e KPM-së. Në këtë periudhë u nominuan gjithsej 77 kandidatë.

Më 21 prill 2007, Komisioni Ad hoc vendosi t'i publikojë emrat e të nominuarve mirëpo pasi që prej minoriteteve ishin paraqitur vetëm nga një kandidatë përveç minoritetit turk e duke dashur të ketë konkurrencë edhe brenda një minoriteti, Komisioni Ad Hoc vendosi që KPM-ja të bëjë edhe një ftesë publike për nominime jo vetëm nga minoritetet, por për të gjithë. Periudha e nominimit zgjati dy javë prej datës 24 prill 2007 deri më 8 maj 2007, dhe gjatë këtij afati u nominuan edhe 25 kandidatë tjerë. Nominimet nga procesi i parë mbetën të vlefshme dhe nuk ishte e nevojshme që ato të përsëriten.

Në takimin e mbajtur më 23 maj 2007, Komisioni Ad Hoc përcakttoi procedurën dhe mënyrën e përzgjedhjes së të nominuarve. Më 6 qershor 2007, prej 102 të nominuarve, me vota të fshehta Komisioni Ad Hoc bëri përzgjedhjen e 18 të nominuarve për anëtarë të Bordit të RTK-së. Emrat e të nominuarve u publikuan në konferencën për shtyp të Komisionit Ad Hoc për Bordin e RTK-së të mbajtur më 7 qershor 2007.

Më 8 qershor 2007, Komisioni Ad Hoc ka paraqitur në Kuvendin e Kosovës emrat e 18 të nominuarve, 9 prej të cilëve do të përzgjidheshin për anëtarë të Bordit të RTK-së. Përzgjedhja është dashur të bëhet nga një Komisioni special Ad Hoc, i përbërë nga një përfaqësues i secilit subjekt politik të përfaqësuar në Kuvend, i cili do të zgjedhë me shumicë të thjeshtë njërin prej dy kandidatëve për secilën pozitë, emërimet e të cilëve për

anëtarë të Bordit do të konfirmohen me akt pro forma të të gjithë Kuvendit. Komisioni Ad Hoc për Bordin e RTK-së është themeluar më 17 shtator 2007.

Sipas Nenit 23 të Ligjit për RTK-në - Nr. 02/L-47, Bordi i RTK-së përbëhet prej 9 anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Bordi është organ drejtues i RTK-së.

## **OBJEKTIVAT PËR VITIN 2008**

*Fillimi i procesit të ri licencimit të të gjitha subjekteve transmetuese ashtu si kërkohet me ligjin për KPM-në*

Të gjitha subjektet transmetuese të cilat operojnë në Kosovë kanë licenca të përkohshme të transmetimit të lëshuara nga Komisioneri i Përkohshëm për Media. Këto licenca janë të vlefshme derisa Këshilli i KPM-së të bëjë licencimin sipas ligjit për KPM-në dhe Transmetim. Sipas Ligjit për KPM-në dhe Transmetim, Këshilli do të lëshojë licenca afatgjate dhe atë 7 vite për radio dhe 10 vite për televizion.

Në tremujorin e fundit të vitit 2007 KPM-ja ka filluar përgatitjet për procesin e ri-licencimit, me qëllim të krijimit të bazës ligjore e cila do të aplikohet përmes një procesi të drejtë dhe transparent.

*Licencimi i operatorëve kabllor dhe ofruesve të shërbimeve programore përmes kabllor*

Në korrik të vitit 2007 Këshilli i KPM-së ka miratuar Rregulloren e Distribuimit Kabllor të Programeve Radio Televizive si dhe Vendimin për Taksën për Licencë për këta operatorë dhe ofruesit e shërbimeve përmes kabllor. Në bazë të kësaj rregulloreje KPM-ja ka bërë regjistrimin fillimisht të këtyre operatorëve aktiv të cilët deri në vitin 2007, për shkak të mungesës së infrastrukturës ligjore nuk kanë pasur mundësi të licencohen. Gjatë muajit gusht 2007 në KPM janë regjistruar 16 operatorë kabllorë, me çka ka filluar legalizimi i veprimtarisë së tyre. KPM planifikon që në vitin 2008 të licencojë operatorët aktivë kabllorë me çka do të rregullohet edhe kjo fushë e re e transmetimit në Kosovë.

*Miratimi i rregullores për subjektet transmetuese mbi mbrojtjen e të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore*

Me qëllim që të sigurohet mbrojtja e të miturve nga përmbajtjet e programeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mental dhe moral Këshilli i KPM-së do të hartojë dhe miratojë Rregulloren për Subjektet Transmetuese mbi Mbrojtjen e të miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore. KPM do të krijojë grupe punuese me psikologë, sociologë dhe edukatorë të cilët do të ndihmojnë në hartimin e kësaj rregulloreje së bashku me Udhëzimin për implementimin e saj.

Kjo Rregullore do t'iu mundësoj subjekteve transmetuese të bëjnë kategorizimin e programeve në bazë të moshës së audiencës si dhe mënyrën e sinjalizimit dhe zgjedhjes së kohës së transmetimit të programeve, që mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental dhe moral të të miturve.

*Përcaktimi dhe implementimi i tarifave vjetore të licencave*

Subjektet transmetuese shfrytëzojnë frekuenca, që janë pasuri publike. Këshilli duhet të caktojë një skemë për tarifën e licencës, për kategori të ndryshme të licencave të transmetimit që do të paguhet për çdo vit nga të licencuarit. Në prill 2007, Këshilli e ka miratuar Vendimin për Taksën për licencë për Radio dhe Televizion në Kosovë. Mirëpo pas ankesës së disa subjekteve transmetuese, Bordi i Ankesave për Media e ka kthyer në rishqyrtim këtë vendim. Këshilli do të rishqyrtojë vendimin dhe në bazë të vendimit të Bordit të Ankesave për Media do të vendos taksën për licencë për subjektet transmetuese.

### *Hartimi i strategjisë për planin frekuencor digjital të Kosovës*

Ligji i KPM-së e autorizon KPM-në që të bëjë rregullimin e transmetimit digjital. Në Raportin Vjetor 2006 të KPM është paraqitur çështja e digjitalizimit (f. 19), çka është dhe cilat janë implikimet e mos përfshirjes së Kosovës nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (UNT) si njësi në vete, dhe KPM-së si rregullator përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin frekuencor për transmetime, në këtë proces.

Në gusht 2007, KPM ka ngritur problemin e digjitalizimit dhe mos përfshirjen e Kosovës në procesin e koordinimit dhe përcaktimit të planit frekuencor digjital për televizione me PSSP-në dhe Qeverinë e Kosovës. Si rezultat i kësaj, PSSP-ja i është drejtuar ITU-së me kërkesën për t'i siguruar UNMIK-ut të dhënat zyrtare për rezultatin e RC-06 dhe për të marrë në konsideratë Kosovën si njësi në vete. ITU nuk është përgjigjur në këtë letër.

Pavarësisht zhvillimeve politike dhe njohjes apo jo të Kosovës si njësi nga ITU, KPM do të fillojë përgatitjet, të hartojë një plan strategjik të tranzicionit nga sistemi analog në atë digjital. Në kërkesën buxhetore për vitin 2008 që KPM ka parashtruar tek Ministria për Ekonomi dhe Financa e Qeverisë së Kosovës projektin për digjitalizimin e Kosovës. Qëllimi i Projektit të digjitalizimit "Plani Frekuencor Digjital i Kosovës për Transmetuesit Tokësor Radio dhe TV" është që të bëhen të gjitha parapërgatitjet e nevojshme teknike për planifikimin digjital.

Momentalisht Administrimi i frekuencave në kompetencë të KPM-së bëhet në bazë të marrëveshjeve ST61, për transmetimet televizive analoge dhe GE84 për radio transmetimet në VHF/FM për brezin 87.5-108 MHz, etj.

## **BORDI I ANKESAVE PËR MEDIA**

Sipas rregullores se UNMIK-ut 2000/36 Nenit 4.4 Bordi i Ankesave për Media (BAM) ishte i përbërë prej dy anëtarëve ndërkombëtar dhe një vendor. Më hyrjen në fuqi të ligjit për KPM-në dhe transmetim përbërja e BAM-ndryshon dhe tani BAM-i përbëhet prej dy anëtarëve vendor dhe një ndërkombëtar.

Bordi i Ankesave për Media është themeluar në pajtim me Nenin 21 të Ligjit të Komisionit të Pavarur për Media dhe Transmetim. Është organ i pavarur gjatë kryerjes së funksioneve të tij. Gjykon ankesat e palëve që drejtpërdrejtë i nënshtrohen vendimit të Këshillit të KPM-së.

BAM mund të mbështetë, ndryshojë ose shfuqizojë çdo vendim të Këshillit të KPM-së që ka të bëjë me ankesën e paraqitur.

### *Procesi i nominimit të Anëtarëve të BAM*

Procesin për nominimin e anëtarëve të BAM-it, KPM e ka filluar në tetor 2006 me qëllim të formimit të BAM në përbërje të re siç kërkohet me Ligjin e KPM-së, ku është përcaktuar që dy anëtarë të jenë vendor dhe një ndërkombëtarë.

Bazuar në Nenin 22 të Ligjit të KPM-së, dy anëtarët vendorë të BAM janë caktuar nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe emëruar nga Kuvendi i Kosovës pas kërkesës publike të nominimeve nga Këshilli i KPM-se, ndërsa anëtari ndërkombëtar është emëruar si Kryetar i Bordit për Ankesa të Mediave (BAM) nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, duke u bazuar në rekomandimet e bëra nga Zëvendësi i Përfaqësuesit Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Ndërtim të Institucioneve.

### *Konstituimi dhe anëtarët*

Më 6 shkurt 2007, në pajtim me Ligjin e KPM-së, është themeluar Bordin i ri i Ankesave për Media. BAM është i përbërë prej një anëtari ndërkombëtar, Prof. Dr. Wolfgang Benedek, Kryetar, dhe dy anëtarëve vendorë: gjyqtar Anton Nokaj dhe gjyqtar Avdi Dinaj. BAM ka miratuar Rregullat e Procedurës më 7 maj 2007.

### *Takimet/rastet/vendimet e BAM*

Bordi i Ankesave për Media gjatë vitit 2007 është takuar në muajt shkurt, qershor, gusht, tetor dhe dhjetor.

Në takimin e muajt shkurt BAM ka shqyrtuar:

**Ankesat numër 2006/19 & 2006/20:** Subjektet transmetues kanë paraqitur ankesë ndaj vendimit të Këshillit KPM-së dhe Bordin i Ankesave për Media ka vendosur që të zvogëlojë gjobat e vendosura nga Këshilli i KPM-së.

**Ankesën numër 2006/22:** Subjekti transmetues ka paraqitur ankesë ndaj vendimit të Këshillit të KPM-së. Bordin i Ankesave për Media ka refuzuar Ankesë Apelimin dhe ka vendosur të konfirmojë vendimin e Këshillit të KPM-së.

## **Në takimin e qershorit BAM ka shqyrtuar këto Ankesa:**

**Ankesat numër 2006/21 & 2006/24:** Subjektet transmetues kanë paraqitur ankesa ndaj vendimit të Këshillit të KPM-së. Bordi i Ankesave për Media ka mbështetur vendimin e Këshillit të KPM-së për të revokuar licencën e Palës Ankuese.

**Ankesa numër 2007/06:** Subjekti transmetues ka paraqitur ankesë ndaj vendimit licencues të Këshillit të KPM-së me të cilin është vendosur që licencën për radio në gjuhën Rome t'ia lëshoj një aplikuesi tjetër. Bordi i Ankesave për Media ka refuzuar Ankesë Apelimin si të pabazuar dhe ka mbështetur vendimin e Këshillit të KPM-së për ti dhënë licencë subjektit tjetër transmetues.

Në takimin e gushtit BAM ka shqyrtuar Ankesat numër 2007/09, 2007/10, 2007/11 dhe 2007/12: Subjektet transmetuese janë ankuar ndaj vendimit të Këshillit të KPM-së CIMC 2007/01 për nivelin, mënyrës së përcaktimit të pagesës së taksës për licencim të radios dhe tv-së. Bordi i Ankesave për Media ka kthyer në rishqyrtim vendimin për nivelin, mënyrës së përcaktimit të pagesës së taksës për licencim të radios dhe TV-së për shqyrtim të serishëm tek Këshilli i KPM-së.

Në takimin e tetorit BAM ka shqyrtuar kundërshtimet e Grupit KOHA kundër Rregullores për reklamim të miratuar nga Këshilli i KPM-së. BAM ka vendosë se është kompetente vetëm për ankesat kundër vendimeve të Këshillit të KPM-së, ndërsa sa i përket Ankesave kundër rregulloreve si akte të një natyre të përgjithshme nuk janë në mandat të Bordit të Ankesave për Media.

Në takimin e dhjetorit BAM ka shqyrtuar Ankesën numër 2007/25, që është bërë ndaj Vendimit të Këshillit të KPM-së për Nivelin, Mënyrën e Përcaktimit të Pagesës së Taksës për Licencim të Operatorëve Kabllor dhe Ofruesve të Shërbimeve të Programeve Përmes Kabllos. Bordi i Ankesave për Media e refuzoi ankesë apelimin si të pabazuar dhe e mbështeti vendimin e Këshillit të KPM-së.

### **Vendimi i BAM-it lidhur me Ankesën 2006/07 dhe ekzekutimi nga KPM**

Në raportin Vjetor 2006 të Komisionit të Pavarur për Media, tek *“Rastet e paraqitura para Bordit të Ankesave për Media”* është dhënë sqarim për Ankesën me numër 2006/07.

*“Ankesa me numër 2006/07, BAM i ka mbajtur dy seanca. Seanca e parë ishte shtyrë për të marrë mendimin e ekspertëve i cili do t'i paraqitej BAM-itë deri në fund të shtatorit 2006. Ekspertë të jashtëm të angazhuar nga KPM dhe subjekti transmetues (TV Mitrovica) kanë vlerësuar se është e mundur të realizohen kushtet dhe termat teknike të caktuara me licencën e subjektit transmetues, të cilin e ka kontestuar subjekti transmetues.*

*BAM ka vendosur që nëse për shkak të kushteve atmosferike subjekti transmetues nuk mund t'i kthejë antenat sipas parametrave teknike të përcaktuar me licencë brenda*

*afatit prej 30 ditëve, atëherë ky afat shtyhet deri me 1 maj 2007. Nëse subjekt transmetues nuk e respekton këtë vendim atëherë pas kësaj date do t'i revokohet licenca në mënyrë automatike."*

Rasti 2006/07 është rasti i TV Mitrovicës. Ky rast ka filluar në vitin 2005 dhe është mbyllur në dhjetor 2007:

- Më 16 shkurt 2005, TV Mitrovica dërgon kërkesën për ndryshim të licencës në të cilën kërkon shtrirje më të madhe të sinjalit të televizionit lokal, dhe atë për të mbuluar me sinjal përveç Mitrovicës edhe Skenderajn, Vushtrin dhe Obiliqin.
- Më 27 prill 2005, Komisioneri i Përkohshëm për Media lëshon vendim me të cilin ndryshon licencën e TV Mitrovicës, duke i lejuar zgjerim të fushës së mbulimit sipas kërkesës së drejtorit të TV Mitrovica. Vendimi u lëshua me kusht që nëse TV Mitrovica dështon në vazhdimësi për t'i përmbushur kushtet e këtij ndryshimi në afat prej 90 ditëve nga data e marrjes së licencës së ndryshuar, atëherë KPM do të mund të lëshojë një urdhër për të rikthyer kushtet dhe termet e mëparshme të transmetimit të TV Mitrovicës.
- Më 11 maj 2005 TV Mitrovica nënshkruan licencën e re të ndryshuar. Me nënshkrimin e kësaj licence të gjitha kushtet e mëparshme të licencës së TV Mitrovica anulohen dhe TV Mitrovica pajtohet t'i përmbahet kushteve dhe termeve të licencës së re.
- Pas matjeve të bëra ne terren, Komisioneri i Përkohshëm për Media, gjen se TV Mitrovica nuk i ka respektuar kushtet e caktuara në vendimin e datës 27 prill 2005, përkatësisht është duke transmetuar në zonën e pa licencuar për transmetim, prandaj më 30 dhjetor 2005 Komisioneri i Përkohshëm për Media lëshon vendimin që TV Mitrovica t'i kthejë antenat e veta në vendndodhjen e mëparshme të licencuar në qendër të Mitrovicës dhe të veprojë në përputhje me kushtet dhe termet teknike të licencës të datës 3 shtator 2001.
- Pas Ankesës nga ana e TV Mitrovicës kundër këtij vendimi në Bordin e Ankesave për Media (BAM), në seancën e mbajtur më 28 shkurt 2006 BAM nuk ishte i kënaqur me mënyrën e dërgimit të vendimit TV Mitrovicës ( dërgimi pas orës 16:00), dhe kërkoi nga Komisioneri Përkohshëm për Media që t'ia dërgoj edhe njëherë vendimin TV Mitrovicës.
- Më 14 mars 2006, Komisioneri i Përkohshëm për Media, ri-lëshon vendimin për licencim 2005/01a të datës 30 dhjetor 2005, si dhe termet dhe kushtet teknike, të cilat i bashkëngjiten këtij vendimi në pajtim me vendimin e BAM-it. Me këtë Vendim Komisioneri i Përkohshëm për Media urdhëron TV Mitrovicën t'i dorëzojë KPM-së pajisjen e linkut, e nevojshme për transmetim të sinjalit të tij nga studioja e tij të lokacioni në Kodrën e Cërnushës, prej nga ishte duke operuar. Dorëzimi i kësaj pajisje të linkut do të kishte efekte vetëm në ndalimin e transmetimit ilegal respektivisht do ta ndalonte TV Mitrovicën të mbuloj zonën e pa licencuar, dhe nuk do të kishte efekt në transmetimin dhe mbulimin me sinjal të zonës për të cilën ishte i licencuar.

Sipas këtij vendimi, TV Mitrovica duhet t'ia dorëzonte këtë pajisje të linkut Zyrës së KPM-së jo më vonë se në orën 17:00, shtatë ditë pas lëshimit të këtij vendimi. KPM do t'ia kthente këtë pajisje TV Mitrovicës me paraqitjen e fakteve të dëshmuar se i ka larguar të gjitha pajisjet transmetuese nga Kodra e Cërnushës. Sipas këtij Vendimi, nëse TV Mitrovica nuk do t'ia dorëzonte pajisjen e linkut KPM-së brenda afatit të përcaktuar në Vendim, TV Mitrovica obligohej të paguante gjobën prej 6,000.00 Euro.

Nëse TV Mitrovica prapë nuk vepron në pajtueshmëri me termet dhe kushtet e licencës së tij dhe nuk e paguan gjobën e tij deri në datën kur gjoba bëhet finale, KPM në këtë rast urdhëron që licenca e TV Mitrovicës të suspendohet deri kur t' i përmbushë të dyja: (a) vepron në pajtueshmëri me termet dhe kushtet e licencës dhe (b) e paguan tërësisht gjobën.

- Më 21 qershor 2006, BAM ka mbajtur seancën shqyrtuese lidhur me ankesën e TV Mitrovicës, kundër vendimit të KPM-së të datës 14 mars 2006. Lidhur me deklaratën e TV Mitrovicës, se është e pamundur teknikisht të zbatohet kushtet dhe termet e licencës së dhënë nga KPM më 11 maj 2005, BAM vendosi se duhet të kërkohet një mendim i ekspertit para se të merret vendimi lidhur me këtë ankesë. Palët ose do të pajtohen për një ekspert të përbashkët, ose secila palë do të propozojë ekspertin e tyre, të cilët pastaj do të shkojnë së bashku në lokacionin dhe vendndodhjen e transmetuesit në Kodrën e Cërnushës, që të përcaktojnë mundësitë teknike të transmetimit sipas kushteve dhe termeve të licencës së TV Mitrovicës. Me këtë vendim BAM pezulloi sesionin e tij për këtë rast në pritje të raportit nga ekspertët. Bordi udhëzoi palët të ndërmarrin këtë hetim dhe të dorëzojnë raportin deri në fund të muajit shtator 2006.
- Më 28 dhe 29 shtator 2006, BAM ka pranuar raportet e ekspertëve lidhur me rastin e TV Mitrovicës. Ky ekip ishte i përbërë prej ekspertit teknik të angazhuar nga KPM, z. Stojan Davcev nga Kompania DASTO (Shkup, Maqedoni) dhe ekspertëve teknik të angazhuar nga TV Mitrovica, z. Dragan Jovic dhe z. Nebojsa Radosevic nga Kompania ASTRATECH (Nish, Serbi). Në këtë raport ekspertët kanë arritur në përfundim dhe janë pajtuar se diagrami i rrezatimit i paraparë nga licenca e TV Mitrovicës e datës 11 maj 2005, teknikisht është i mundur të realizohet.
- Më 10 nëntor 2006, Bordi i Ankesave për Media ka mbajtur seancën shqyrtuese me qëllim të shqyrtimit të raporteve të ekspertëve për rastin e TV Mitrovicës.
- Më 27 nëntor 2006, Bordi i Ankesave për Media ka lëshuar vendim për TV Mitrovicën pas shqyrtimit të raporteve të ekspertëve. Në vendim thuhet se në bazë të opinionëve të ekspertëve dhe seancës shqyrtuese të mbajtur lidhur me këtë rast:

*“TV Mitrovica urdhërohet t’i sjell antenat e saj në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara në licencën e saj më 11 maj 2005, brenda afatit prej 30 ditëve pas pranimit të këtij vendimi. Më tej, në vendim thuhet se nëse për shkak të kushteve atmosferike nuk do të jetë e mundur për Palën Ankuese që të*



*rregullojë antenat e saj në përputhje me kushtet e licencës brenda periudhës prej 30 ditëve, bordi urdhëron Palën Ankuese të sjell antenat e saj në përputhje me licencën e saj të lëshuar më 11 maj 2005, sa ma shpejt që të jetë e mundur, më së voni deri më 1 maj 2007, përndryshe licenca automatikisht do t'i merret në atë datë.”*

*(Vendimi 2006/7 i BAM-it, paragrafi 6 dhe 7)*

Pas vendimit të BAM-it, KPM ka bërë në vazhdimësi monitorimin e rastit për të vlerësuar nëse subjekti transmetues është duke vepruar në pajtueshmëri me vendimin.

- Më 23 prill 2007, KPM ka bërë monitorimin e TV Mitrovicës nga qyteti i Ferizajt dhe me këtë rast është regjistruar nivel i lartë i sinjalit të TV Mitrovicës në kanalën 42, kanal nga i cili TV Mitrovica transmetonte programin e vet nga pika transmetuese në Kodrën e Cërnushës. Sipas raportit të ekipit të menaxhimit të frekuencave, duke u bazuar në matjet e bëra në Ferizaj, është vërejtur se TV Mitrovica vazhdonte të transmetojë dhe të mbulojë zonat për të cilat nuk është e licencuar.
- Më 24 prill 2007, Komisioni i Pavarur për Media i dërgon letër TV Mitrovicës me të cilën e njofton për obligimet që i ka nga vendimi i BAM të datës 27 nëntor 2006. Me këtë letër TV Mitrovicës i është bërë me dije se nëse deri më 1 maj 2007 nuk përmbushë obligimet që dalin nga Vendimi i Bordit, atëherë nga kjo datë, do të konsiderohet si subjekt transmetues ilegal dhe do të merren të gjitha masat ligjore si ndaj çdo transmetuesi ilegal në pajtim me Ligjin e KPM-së.
- Divizioni për Menaxhim të Frekuencave ka vazhduar me matje edhe në datat 15 dhe 30 maj si dhe me 6 qershor e 2 korrik 2007. Matjet kanë vërtetuar prezencën e sinjalit të TV Mitrovica në regjionet për të cilat TV Mitrovica nuk kishte licencë që t'i mbulojë.
- Më 8 qershor 2007, KPM kontakton drejtorin e TV Mitrovicës dhe kërkon përgjigje në lidhje me njoftimin e datës 24 prill 2007. Drejtori i TV Mitrovica ka dërguar një email më datën 9 qershor, përmes të cilit kërkon falje që nuk e ka njoftuar me kohë KPM-në për ndryshimet që me datë 30 Prill 2007, i ka bërë në sistemin e antenave, me qëllim të përshtatjes me kushtet dhe termet e licencës. Këtë ka thënë se mund ta dëshmojë me fletëpagesën për kryerjen e shërbimit, dhe fotot nga shtylla në Cërnushë (të cilën thoshte se do ta dërgoj më vonë). Zyra i është përgjigjur këtij emaili me datën 27 qershor 2007, në të cilin nga drejtori i TV Mitrovicës është kërkuar një takim për të biseduar për këtë çështje dhe i është kërkuar që të sillen dokumentet të cilave drejtori iu është referuar në emailin e 9 qershorit.
- Më 29 qershor 2007, TV Mitrovica ka dërguar përmes emaili fotot e sistemit të antenave të tyre si dëshmi, së ka bërë ndryshimin e sistemit të antenave sipas vendimit të BAM, por që në fakt kjo foto nuk tregonte asgjë tjetër vetëm sistemin e antenave ashtu si ka qene edhe me parë pa kurrfarë ndryshimi të bërë. Po të njëjtën ditë Shefja Ekzekutive e KPM-së është takuar më drejtorin e TV Mitrovica i cili ka dorëzuar edhe një fletëpagesë me pohimin sipas tij për shërbimet e

rregullimit të sistemit të antenave, një fletëpagese e thjeshtë në të cilën ka qenë i fshirë emri i kompanisë apo personit që i ka i është bërë pagesa. Në fakt kjo fletëpagese nuk tregonte asgjë. Në këtë takim i është thënë TV Mitrovicës së nuk është duke transmetuar sipas kushteve dhe termeve të licencës dhe i është kërkuar që të vijë në pajtueshmëri me vendimin e BAM-it, përndryshe, zyra duhet të ekzekutojë vendimin e BAM.

Gjithashtu drejtorit të TV Mitrovicës i është sqaruar që Zyra nuk është e interesuar të bëjë konfiskimin e pajisjeve të TV Mitrovicës, por nëse TV Mitrovica nuk vjen në pajtueshmëri me termet dhe kushtet e licencës, atëherë ajo detyrohet ta bëjë zbatimin e vendimit të BAM-it. Takimi nuk ka rezultuar me ndonjë mirëkuptim apo qëndrim për zgjidhje të problemit. Në takim në asnjë moment nuk është mohuar nga drejtori i TV Mitrovicës se TV Mitrovica transmeton jashtë kushteve të licencës. TV Mitrovicës i është bërë e qartë që dy dëshmitë që ka ofruar në KPM si provë e sjelljes në pajtueshmëri me vendimin e BAM-it, do të verifikohen nga Zyra dhe varësisht prej rezultateve do të ndërmerren apo jo masat ekzekutive të vendimit të BAM-it.

- Stafi i KPM-së ka shkuar në Cërnushë më 2 korrik 2007 për të verifikuar nëse TV Mitrovica ka bërë ndryshimet në sistemin e antenave dhe ka gjetur se situata (drejtimi i antenave dhe lartësia e antenave) është e pandryshuar. TV Mitrovica ka vazhduar të transmetojë në kundërshtim me kushtet dhe termet teknike të licencës së lëshuar me 11 maj 2005.
- Këshilli i KPM-së që nga data 28 gusht 2007 ka mbetur pa dy anëtarë vendorë dhe një anëtar ndërkombëtar për shkak të përfundimit të mandatit njëvjeçar të tyre. Gjatë periudhës qershor – gusht nuk ka pasur takim të Këshillit. Pas verifikimit të mos respektimit të Vendimit të BAM-it, Zyra e Shefit Ekzekutiv ka qenë e obliguar të veprojë në pajtueshmëri me ligjin dhe të ndërmarrë masat ndaj TV Mitrovicës si subjekt transmetues ilegal. Pasi që duhej ndërprerë transmetimi ilegal, Zyra e Shefit Ekzekutiv nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme në muajin korrik, duke pritur mundësinë e takimit të Këshillit dhe ofrimit të mundësisë që të ketë televizion në gjuhën shqipe në Mitrovicë, përmes hapjes së tenderit të cilin mund ta bënte vetëm Këshilli.
- Më 9 nëntor 2007, është takuar Këshilli i cili ka vendosur që tenderin për TV në Mitrovicë ta shqyrtojë në takimin e radhës.
- Me 26 dhjetor 2007, TV Mitrovicës i është dërguar Njoftim për Shkelje të Ligjit të KPM-së, dhe i është kërkuar ndërprerja e menjëhershme e transmetimit, në të kundërtën do t'i konfiskoheshin pajisjet e transmetimit.
- Me 28 dhjetor 2007, KPM ka lëshuar urdhrin për konfiskimin e pajisjeve të TV Mitrovicës, më ç'rast edhe TV Mitrovicës i janë konfiskuar pajisjet e transmetimit në Cërnushë. TV Mitrovica ka filluar sërish më transmetim ilegal edhe pas kësaj date dhe më 2 janar 2008 i është dërguar njoftim për shkelje më të cilin është kërkuar të ndërpres transmetimin ilegal dhe të lirojë kanalën e uzurpuar, në të

kundërtën KPM-ja do të marrë masa për konfiskimin e pajisjeve të transmetimit. Pas kësaj date TV Mitrovica nuk është duke transmetuar.

- Më 7 shkurt 2008, Këshilli i KPM-së ka vendosur që të hap tender, për televizion lokal në qytetin e Mitrovicës, gjë të cilën edhe e ka bërë me 13 shkurt 2008.

Veprimi në rastin e TV Mitrovicës është një pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të siguruar pajtueshmërinë e të gjitha subjekteve transmetuese me Ligjin dhe Rregulloret e KPM-sw. Në përgjithësi, KPM ka pasur bashkëpunim të mirë me të gjitha subjektet tjera transmetuese.

Pas disa reagimeve kryesisht politike që janë bërë nga përfaqësuesit e disa partive politike, Kryetari i Bordit të Ankesave për Media, Prof. Dr. Wolfgang Benedek, me 6 shkurt 2008, ka lëshuar deklaratën lidhur me vendimin për TV Mitrovicën.

#### *Deklarata e Kryetarit të Bordit të Ankesave për Media*

Bordi i Ankesave për Media është marrë me shqyrtimin e shkeljes së licencës së saj nga TV Mitrovica që prej vitit 2005 (Vendimi 2005/41). Për hir të lirisë së shprehjes, Bordi i ka dhënë z. Spahiu disa mundësi për ta kthyer mbulueshmërinë e stacionit të tij në pajtim me licencën e tij. Z. Spahiu është pajtuar me faktin e gjetur nga ekspertët për të sqaruar nëse kjo është e mundshme teknikisht. Ekspertët kanë konfirmuar se në të vërtetë kjo është e mundur.

Përfundimisht, në Vendimin 2006/7 atij iu dha mundësia e fundit me afatin e caktuar deri më 1 maj 2007, gjatë së cilës kohë, licenca e tij automatikisht do të revokohej, nëse ai nuk do kishte vepruar në pajtueshmëri me obligimet e tij. Paneli mori këtë vendim sepse të gjitha çështjet ligjore dhe teknike ishin vendosur përpara.

Pasi që z. Spahiu, fatkeqësisht, nuk është sjellë në pajtueshmëri me ligjin, KPM-së i është dashur të ndërmarr masa dhe të veprojë, përndryshe, e tërë procedura ligjore e tre anëtarëve të Bordit të Ankesave për Media, të cilët kanë vepruar në kuadër të ligjeve relevante, do të ishte e kotë.

Çështja themelore është se zbatimi i ligjit duhet të mbizotërojë edhe nëse ka arsye të kuptueshme politike. Prandaj, zgjidhja e vetme e pranueshme e këtij rasti mund të bazohet në respektim të zbatimit të ligjit.

#### *Ankesat e parashtruara për shqyrtim në BAM*

Në dhjetor të vitit 2007, tek Bordi i Ankesave për Media janë parashtruar ankesat me numër 2007/07 dhe 2007/15 të cilat kanë mbetur të procedohen në vitin 2008.

## **ZYRA E SHEFIT EKZEKUTIV**

Zyra e Shefit Ekzekutiv duhet të zbatohet të gjitha aspektet e politikës së transmetimit; të përgatisë propozimin për buxhetin dhe t'i bëjë rekomandime Këshillit përkitazi me çështjet e politikës së transmetimit dhe çështjet lidhur me buxhetin dhe administratën.

Zyra e Shefit Ekzekutiv gjatë vitit 2007 ka pasur 21 punonjës, shërbyes civilë, nga 24 sa duhet të ketë gjithsej. KPM është përballur me probleme buxhetore të cilat kanë ndikuar në mos realizimin e numrit të planifikuar të punëtorëve.

Në strukturën organizative, Zyra e SHE-së ka dy departamente dhe 5 divizione: departamentin e Rregullimit të Transmetimit në kuadër të të cilit hyjnë Divizioni Ligjor, i Licencimit, i Menaxhimit Frekuencor dhe Divizioni për Monitorim dhe Pajtueshmërisë së Mediave dhe Departamenti i Administratës.

## **DEPARTAMENTI I RREGULLIMIT TË TRANSMETIMIT**

Departamenti i Rregullimit të Transmetimit mbikëqyrë aktivitetet e përgjithshme të KPM-së duke koordinuar punët e divizionit Ligjor, Licencimit, Monitorimit/Pajtueshmërisë dhe Menaxhimit Frekuencor. Ofron mbështetje dhe këshilla për Shefin Ekzekutiv për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me licencimin, zbatimet dhe zhvillimet e politikave rregullative të KPM-së. Mbikëqyr zhvillimet e politikave dhe procedurave rregullative të transmetimit dhe koordinon zhvillimet profesionale të personelit brenda Departamentit Rregullativ.

## **DIVIZIONI LIGJOR**

Divizioni Ligjor këshillon KPM-në në të gjitha çështjet ligjore që kanë të bëjnë me licencimin, ankesat prej publikut dhe përgatitjen e rregullave dhe udhëzimeve të reja për subjektet transmetuese. Divizioni Ligjor përgatit rastet sanksionuese dhe këshillon KPM-në në të gjitha seancat ligjore.

Divizioni Ligjor gjithashtu shërben si këshilldhënës i përgjithshëm i KPM-së, në këshillimet administrative si dhe në çështjet rregullative. Gjatë vitit 2007 ky Divizion ka proceduar 35 raste.

### *Rastet për dështim të sjelljes së arkivës*

Ankesa me numër 2007/18, KPM i ka lëshuar Njoftim për Shkelje të Nenit 11.1 të Kodit të Sjelljes së Mediave Elektronike, për mos sjellje të arkivës. Rasti në procedim.

### *Rastet për interferenca*

Divizioni Ligjor ka proceduar Ankesën me numër 2007/05 ku subjekti transmetues i ka shkaktuar interferenca një subjekti tjetër transmetues. Pasi që KPM i ka dërguar Urdhër që orientimin e antenave, hartën e mbulimit si dhe fuqinë transmetuese t'i ri-sjellë në pajtueshmëri me Pjesën II-të të Licencës, ky subjekt transmetues është në pajtueshmëri me Pjesën e II-të të Licencës. Rasti është mbyllur.

Rastet për ndërprerje transmetimi

Divizioni Ligjor ka proceduar vetëm një rast me numër 2007/04 për mos transmetim me shumë se 90 ditë siç është paraparë me licence për të rifilluar transmetimin. Këshilli i KPM-së lëshoi vendim më të cilin urdhëroi subjektin transmetues të rifillojë transmetimin e programit siç obligohet me Licencë. Ky subjekt transmetues për shkak të vështirësive financiare ka hequr dorë vullnetarisht nga licenca e KPM-së.

Rastet e paraqitura nga palët ndaj lajmeve dhe programeve të RTK-së

Në divizionin ligjor janë proceduar dy raste Ankesa me numër 2007/08 ndaj edicionit të lajmeve të RTK-së. Shefi Ekzekutiv i Komisionit të Pavarur për Media, në pajtueshmëri me kompetencat e dhëna nga Këshilli ka marr vendim ta hedh poshtë ankesën si të pa bazuar.

Ankesa me numër 2007/29, ndaj programit “Mostovi” të RTK-së, për fyerje dhe dyshim të supozuar. Rasti është në procedim.

Ankesa me numër 2007/30 ndaj edicionit të lajmeve të RTK-së për raportim tendencioz dhe keq informim i RTK-së është ende në procedim.

Rastet e paraqitura nga palët ndaj lajmeve të TV 21

Ankesa me numër 2007/32, ndaj edicionit të lajmeve të TV 21. Rasti është në procedim.

Rastet e transmetimit nga vendi i pa licencuar

Ankesa me numër 2007/13, subjekti transmetues ka ndërruar lokacionin e sistemit të transmetimit pa miratim me shkrim nga KPM me këtë veprim ka bërë shkelje të Pjesës së II-të Licencës. KPM i ka dërguar Njoftim për Shkeljen e bërë duke i rikujtuar këtij subjekti transmetues se sipas licencës nuk mund ta ndërroj vendin e transmetuesit pa pëlqimin paraprak me shkrim të KPM-së. KPM i ka lëshuar Urdhër këtij subjekti transmetues me qëllim që sistemin e transmetimit ta kthejë në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara me licencë. Rasti është duke u proceduar nga Divizioni Ligjor.

Rastet për transmetim pa të drejtën autoriale

Ankesa me numër 2007/02, ndaj një subjektit transmetues i cili ka bërë transmetimin e programit të subjektit tjetër transmetues pa të drejtën autoriale. Këshilli i KPM-së morri vendim me të cilin ka hedhur poshtë ankesën e subjektit transmetues duke e cilësuar si të pabazuar. Rasti është mbyllur.

Rastet e paraqitura gjatë fushatës zgjedhore

Lidhur me mos mbulimin e fushatës zgjedhore apo keqinformimin gjatë kësaj periudhe janë pranuar Ankesat me numër 2007/16, 2007/17, 2007/19, 2007/20, 2007/21, 2007/22, 2007/23, 2007/24, 2007/26, 2007/27, 2007/28, 2007/31, 2007/33, 2007/34, 2007/35 të cilat janë ende në procedim nga Divizioni Ligjor i KPM-së.

## **DIVIZIONI I LICENCIMIT**

Divizioni i Licencimit është përgjegjës në udhëheqjen e konkurseve të licencimit lidhur me licenca të reja transmetimi në territorin e Kosovës. Gjithashtu, Divizioni i Licencimit punon ngushtë me të gjitha subjektet transmetuese ekzistuese në çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së tyre. Në bashkëpunim me divizionet tjera të KPM-së, Divizioni i Licencimit udhëzon të gjitha subjektet transmetuese për të zgjidhur problemet e interferencave në mes tyre dhe bënë shqyrtimin e të gjitha kërkesave të subjekteve transmetuese që kanë të bëjnë me ndryshimet në Kushtet e Përgjithshme të licencës së tyre.

### *Aktivitetet në Divizionin e Licencimit*

Gjatë vitit 2007, Divizioni i Licencimit ka pranuar kërkesa dhe ankesa të ndryshme nga bartësit e licencave. Gjithashtu, janë iniciuar edhe raste *ex-officio* kur është vërejtur shkelje e kushteve dhe termeve të licencës nga ana e subjekteve transmetuese. Në Divizionin e Licencimit gjatë vitit 2007 janë paraqitur gjithsej 34 raste të natyrave të ndryshme që kishin të bënin me shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së.

Nga viti 2006, në Divizionin e Licencimit janë bartur nëntë raste. Për shkak të mos respektimit të afateve të përcaktuara nga Divizioni i Licencimit për të vepruar në pajtueshmëri me kushtet dhe termet e licencës së KPM-së nga ana e subjekteve transmetuese pesë prej këtyre rasteve, kanë kaluar te Divizioni Ligjor dhe janë në proces. Katër prej tyre konsiderohen të përfunduara dhe të mbyllura nga Divizioni i Licencimit.

Kushtet dhe termet e licencimit janë përcaktuar për t'u siguruar që secili subjekt transmetues i shërben interesit të gjerë publik me qëllim të një rregullimi profesional dhe të paanshëm të transmetimit. Me ndihmën e Divizionit të Monitorimit, Divizionit Ligjor dhe Divizionit të Menaxhimit Frekuencor, Divizioni i Licencimit ka ofruar udhëzime dhe sugjerime për subjektet e licencuara transmetuese sipas nevojës duke zgjidhur problemet dhe kërkesat e tyre që janë paraqitur në KPM, respektivisht në Divizionin e Licencimit.

## **DIVIZIONI I MONITORIMIT DHE PAJTUESHMËRISË SË MEDIAVE**

Divizioni i Monitorimit dhe Pajtueshmërisë monitoron mediat elektronike dhe periodikisht viziton subjektet transmetuese për të siguruar pajtueshmërinë me rregulloret e KPM-së dhe për të ndihmuar KPM-në që më mirë të kuptoj problemet dhe shqetësimet e subjekteve transmetuese. Monitoruesit e KPM-së pranojnë ankesa prej publikut dhe i shqyrtojnë ato në konsultim me Divizionin Ligjor, Teknik dhe të Licencimit në mënyrë që të këshillojnë Shefin Ekzekutiv për çfarëdo veprimi rregullativ që mund të kërkohet dhe gjithashtu mund të iniciojë ankesë të vet *ex-officio*.

Për Divizionin e Monitorimit dhe Pajtueshmërisë së Mediave viti 2007, ishte vit i realizimit të suksesshëm të shumë projekteve të monitorimit. Vlerësimi i pajtueshmërisë së subjekteve transmetuese me Kushtet dhe Termet e Licencës, Kodin e Sjelljes së

Mediave Elektronike dhe rregulloret e Komisionit të Pavarur për Media, ishin në fokus të projekteve të realizuara të këtij divizioni.

Me qëllim të inspektimit dhe verifikimit të pajtueshmërisë së mediave me Kushtet dhe Termet e Licencës, gjatë muajve të verës stafi monitorues ka vizituar të gjitha subjektet transmetuese në të pesë regjionet administrative. Përmes këtyre vizitave dhe kontakteve me përfaqësuesit e radiove dhe televizioneve, monitoruesit janë njoftuar më për së afërmi me shqetësimet, problemet si dhe të arriturat e subjekteve transmetuese.

Periudha e zgjedhjeve të nëntorit 2007, ishte periudhë e mobilizimit shtesë e të gjithë stafit monitorues të ZKPM-së për të bërë vlerësimet mbi raportimin e drejtë dhe të paanshëm të mediave elektronike gjatë fushatës zgjedhore, veprimin në pajtueshmëri me Rregullën Zgjedhore 11/2007 të KQZ-së, dhe Udhëzuesit për Zbatimin e Heshtjes Zgjedhore.

Me këtë rast të gjitha radiove dhe televizioneve u është kërkuar arkiva e programeve të emetuara më 16 e 17 nëntor, të cilat pastaj janë monitoruar dhe analizuar për pajtueshmëri me Udhëzuesin për heshtjen zgjedhore.

Monitoruesit janë pikë e parë e kontaktit me ankesat e parashtruara nga qytetarët si dhe me rastet ex-officio, të iniciuara nga vet zyra e KPM-së. Lidhur me këto ankesa, Divizioni i Monitorimit ka bërë raporte të monitorimit e analiza të shumta. Gjetjet e monitoruesve lidhur me programet për të cilat janë ngritur ankesat ishin bazë mbi të cilën Divizioni Ligjor ka mbështetur shumë vendime të ndërmarra ligjore. Mungesa e kapaciteteve teknike që do t'i mundësonte Divizionit të Monitorimit të bënte monitorimin dhe analizën e përmbajtjeve programore të subjekteve transmetuese në të pesë regjionet administrative, veçanërisht në rastet e ankesave, paraqet vështirësi të mëdha për të proceduar ankesat e parashtruara nga publiku por edhe për të prodhuar raporte të veta për kategori të ndryshme programesh.

Sigurimi i një sistemi monitorimi të avancuar është nevojë e patjetërsueshme. KPM ka paraqitur pranë Qeverisë së Kosovës, me parashtrësën e buxhetit, Projektin për monitorim të programeve radio difuzive të operatorëve tokësor të Kosovës . Në këtë projekt janë paraqitur detajet teknike dhe organizative për realizimin e tij. Projekti ka të bëjë me krijim të sistemit të monitorimit të emetuesve FM dhe TV nga shtatë qendra tona të Kosovës (Prizreni, Peja, Gjakova, Gjilani, Mitrovica, Ferizaj dhe qendra në Prishtinë) në mënyrë që nga qendra monitoruese në Prishtinë të mund të: monitorohen, të incizohen dhe të ruhen sinjalet radiotelevizive nga qendrat e lartë përmendura dhe atë nga 2 TV dhe 1 Radio stacion nga çdo qendër e lartpërmendur.

## **DIVIZIONI I MENAXHIMIT FREKUENCOR**

Divizioni i Menaxhimit Frekuencor (DMF) cakton parametrat e transmetimit për secilin subjekt transmetues, përfshirë frekuencat, fuqinë e sinjalit dhe lokacionin e antenës. Duke përdorur programe planifikuese të sofistikuara të frekuencave, Divizioni i Menaxhimit Frekuencor harton hapësirën e mbulimit të secilit subjekt transmetues në një hartë shumë të saktë topografike të Kosovës për të siguruar që secili radio stacion apo televizion mund të mbulojë hapësirën e vet të licencuar pa i penguar subjektet tjera transmetuese. DMF-ja po ashtu kryen veprime monitoruese në terren për të verifikuar pajtueshmërinë e

subjekteve transmetuese me kushtet teknike të licencave të tyre dhe mbikëqyrë zgjidhjen e çështjeve të interferencave të frekuencave të transmetimit në mes të transmetuesve.

DMF ka realizuar në vazhdimësi monitorime teknike në tërë territorin e Kosovës me qëllim të vlerësimit të situatës në rastet kur janë paraqitur kërkesa për asistencë teknike të KPM-së nga subjektet transmetuese. Nga studimi i të dhënave të grumbulluara gjatë vlerësimeve teknike të rasteve, në të shumtën janë vërejtur probleme me ndërhyrjet e stacioneve tek njeri tjetri si rezultat i cilësisë së dobët të aparaturave transmetuese .

DMF ka proceduar një numër të konsiderueshëm të rasteve për interferenca që janë iniciuar nga ankesat e subjekteve transmetuese si dhe ka vlerësuar dhe ka bërë rekomandime lidhur me kërkesat për ndryshime të lokacionit të sistemit të transmetimit. DMF ka arritur të identifikojë shkaktarët e problemeve teknike të paraqitura tek subjektet transmetuese dhe sipas rekomandimeve të këtij divizioni, KPM ka lëshuar vendime për zgjidhjen e atyre problemeve.

## **DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS**

Departamenti i Administratës është përgjegjës për të gjitha çështjet financiare, të personelit, logjistikës dhe prokurimit në KPM, përfshirë menaxhimin e buxhetit të saj (që rrjedh prej Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës).



## PASQYRA E BUXHETIT TË KPM-së PËR VITIN 2007

Planifikimi i Buxhetit i vitit 2007 ka filluar me buxhetin e aprovuar në shumën prej 358,478.00 Euro. Prej buxhetit të aprovuar me rishikimin e gjysmë-vitit në bazë të Udhëzimit Administrativ 2007/10 KPM ka pasur një ndryshim të ndarjeve buxhetore në kategorinë e pagave. Është zbritur shuma prej 6,884.00 për shkak të mjeteve të lira prej gjysmëvitit në mungesë të mosplotësimit të numrit të të punësuarve. Shuma e pashpenzuar nga ndarjet buxhetore është suficiti prej 21,887.00 Euro që dmth se KPM ka realizuar një planifikim të buxhetit për 94% të shfrytëzimit të buxhetit.

Komisioni i Pavarur për Media prej fondit të Donatorëve të vitit 2006 që ka qenë në shumën prej 20,000 euro (donacioni i dhënë nga OSBE-ja të projektit të realizuar të fushatës për sensibilizimin e opinionit publik për KPM-në) ka shpenzuar 17,874.12 euro kurse në vitin 2007, ka shpenzuar 400.00 euro. Shuma e pa shpenzuar e këtij donacioni prej 1,725.88 i është kthyer donatorit në pajtueshmëri me marrëveshjen paraprake për shfrytëzimin e këtyre mjeteve.

	<b>Buxheti i Aprovuar</b>	<b>Alokimet Buxhetore</b>	<b>Shpenzimet</b>	<b>Buxheti i Pashpenzuar</b>	<b>Alokimi i Pashpenzuar</b>
Kompenzimi i të Punësuarve	79,269.00	72,385.00	68,765.00	3,620.00	3,620.00
Mallrat dhe shërbimet	259,209.00	259,209.00	247,027.00	12,182.00	12,182.00
Shpenzimet Komunale	20,000.00	20,000.00	13,914.00	6,085.00	6,085.00
<b>Totali</b>	<b>358,478.00</b>	<b>351,594.00</b>	<b>329,707.00</b>	<b>21,887.00</b>	<b>21,887.00</b>
Fondi i Donatorëve		400.00	400.00		
<b>Totali</b>		<b>400.00</b>	<b>400.00</b>		

Nr	Emërtimi	Alokimet		Fondi i Donatorëve	Totali
		Të Hyrat Vetanake	Llogaria e Thesarit granti i Qeverisë		
					<b>(3+4+5)</b>
1	2	3	4	5	6
1.	Të Hyrat(1a deri 1c)				351,994.00
a	Granti i Qeverisë		351,594.00		351,594.00
b	Të Hyrat vetanake				
c	Grantet e përcaktuara			400.00	400.00
2.	Shpenzimet(a deri c)		329,707.00	400.00	330,107.00
a	Kompensimet e të Punësuarve		68,765.00		68,765.00
b	Mallra dhe Shërbime		247,027.00	400.00	247,427.00
c	Shpenzimet Komunale		13,914.00		13,914.00
3.	Gjendja e të Hyrave të Pashpenzuara(nr.1-nr.2)		-21,887.00		-21,887.00
4.	Granti i Qeverisë i Pashpenzuar(-nr.3kol.4)		21,887.00		21,887.00
<b>5.</b>	<b>Totali(nr. 3+-4)</b>		<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

## **PREZANTIMI I KPM-së NË RAPORTIN E PROGRESIT TË KOMISIONIT EVROPIAN**

Me 6 nëntor 2007 është publikuar dokumenti “Raporti i Progresit 2007 për KOSOVËN nën RKSOKB 1244’ në të cilin tek pika 4.3.6 “Shoqëria informative dhe mediat”. Në këtë raport është cekur se “*sa u përket politikave audiovizuale, korniza rregullative është përmirësuar rrënjësisht vitin e kaluar [...] Sidoqoftë, një vit e gjysmë pas aprovimit të ligjit relevant, bordi i transmetuesit publik (RTK) nuk është emëruar ende. Që nga 1 shkurti 2008, KEK, kompania energjetike do të përfundojë mbledhjen e pagesës së RTK-së përmes faturave të KEK-ut. Financimi stabil dhe i vazhdueshëm për RTK-në dhe për Fondin e Mediave Minoritare, është jetik për arritjen e objektivave të shërbimit të transmetuesit publik dhe për qasje të të gjitha komuniteteve në informata. [...] Zyrтари Kryesor Ekzekutiv i Komisionit të Pavarur për Media (KPM) është emëruar. Minoriteti serb përfaqësohet në KPM.*”

*KPM është përgjegjëse për menaxhim, rregullim dhe sjellje të resurseve të spektrit të frekuencave të transmetimit, për hartimin e legjislacionit sekondar, licenca dhe për mbledhjen e detyrimeve për përdorimin e frekuencave të transmetimit në Kosovë. Deri tani, KPM ka licencuar 117 transmetues në Kosovë. KPM ka ndihmuar Qeverinë të draftojë një politikë për mediat minoritare dhe multi-etnike dhe të krijojë një fond për mbështetjen e mediave minoritare dhe multi-etnike. KPM ende duhet të adresojë çështje të rëndësishme si de-kriminalizimi i shpifjes dhe fyerjeve. Grupet punuese janë duke shikuar çështjet si koncentrimi i mediave dhe rregullimi i pragut minimal reklamues.”*

Për herë të parë Komisioni i Pavarur për Media, gjatë periudhës për të cilën raportohet, ka filluar të jetë pjesëmarrës në takimet e grupeve punuese *Acquis* mbi Transport, Shoqëri Informative dhe Media. Kjo është realizuar përmes Agjencionit për Integritet Evropian që vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Në Planin e Veprimit për Partneritet Evropian, në kuadër të prioritetëve të institucioneve Kosovare kanë qenë të përcaktuara dy prioritete për të cilat ka qenë përgjegjëse Komisioni i Pavarur për Media; prioriteti 33 dhe prioriteti 91.

KPM ka raportuar në vazhdimësi për progresin e bërë në relacion me këto prioritete, dhe në takimin e Grupit *Acquis* të datës 3 maj 2007, ka prezantuar para përfaqësuesve të institucioneve vendore, ndërkombëtare dhe përfaqësuesve të Komisionit Evropian punën e KPM dhe planet e veprimit për të përmbushur obligimet e veta në këtë drejtim.

Më 7 nëntor 2007, pas publikimit të raportit të progresit, me ftesë të ZKM-së, KPM ka marrë pjesë në takimin e trembëdhjetë të Mekanizmit Përcjellës për Procesin e Stabilizim-Asocimit (MPSA). Këtu është diskutuar për secilën fushë të mbuluar në raportin e progresit të KE-së dhe secilit institucion i është dhënë mundësia e sqarimeve shtesë. KPM po ashtu ka pasur mundësinë të sqarojë detajet për secilën çështje të ngritur në raport.

## **PËRFAQËSIMI I KPM-së NË TAKIMET DHE KONFERENCAT VENDORE, REGJIONALE DHE EVROPIANE**

*Takimet e Qendrës për Integritet Ndërkombëtar RAE*

Përfaqësues të KPM-së, kanë marrë pjesë në katër takimet e komuniteteve Rome, Ashkalinj dhe Egjiptian (RAE), për të ofruar kontributin në realizimin e projektit me titull “*Strategjia e Qeverisë për Integrimin e komuniteteve RAE*“. Përfaqësuesit e KPM-së kontribut të veçantë në këtë projekt ka dhënë në pjesën e diskutimit për nevojat dhe mundësitë e zhvillimit të informimit të komunitetit RAE në gjuhën e tyre. Këto takime ishin të mbështetura kryesisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – SOROS.

#### Konferenca “Mediat dhe sundimi i ligjit në Kosovë”

Me 11 qershor 2006 është organizuar konferenca Media dhe sundimi i ligjit në Kosovë nga Deutsche Welle dhe Fridrich Ebert Stiftung, në të cilën përfaqësuesi i Zyrës së KPM-së ka qenë i ftuar që të diskutojë në temën: Roli i rregullatorit në krijimin dhe implementimin e kornizës ligjore për mediat elektronike.”

#### Takimet e rregullta vjetore në kuadër të EPRA-s

Përfaqësues të Zyrës së Shefit Ekzekutiv të KPM-së kanë marrë pjesë në dy konferenca të organizuara nga Platforma Evropiane e Agjencioneve Rregullative (EPRA), anëtare e së cilës është edhe KPM që nga viti 2003.

#### Takimi i 25-të i EPRA-s në Pragë - Çeki

Në bazë të ftesës zyrtare nga Këshilli për Transmetim Radio Televiziv të Çekisë, përfaqësues të zyrës së Shefit Ekzekutiv të KPM-nga data 16 deri më 18 maj 2007 për të marrë pjesë në takimin e 25-të të EPRA-s. Tema kryesore e diskutimit ishte pavarësia e agjencioneve rregullative. Pjesë e Konferencës ishte edhe takimi i tri grupeve punuese lidhur me Blurring Boundaries, Çështje të Reja rreth Reklamimit dhe Ndarjes Editoriale, Koncentrimi i Mediave dhe Pluralizmi, Çështjet Aktuale Brengosëse dhe Performanca e Transmetuesit Publik, Vlerat Publike dhe Testet në Ndikimet e Tregut.

Nga takimi i grupit të parë u kuptua se disa lloje të programeve si kuize apo programe që ofrojnë diskutime të drejtpërdrejta mund të konsiderohen nga disa vende si një lloj tjetër i reklamimit. Prandaj, në këto vende është duke u punuar në lidhje me definimin e këtyre llojeve të programeve dhe mënyrën e rregullimit të tyre.

Seanca plenare vazhdoi me temë diskutimi lidhur me licencimin e ofruesve të rinj përmbajtjesorë të mediave IPTV. Pjesëmarrësit fokus të veçantë diskutuan lidhur me mënyrën dhe standardet e licencimit si dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Në këtë konferencë, përfaqësuesit e KPM-së u takuan me përfaqësuesit e Këshillit të Evropës si dhe me përfaqësuesit e rregullatorëve regjional me të cilët diskutuan për çështjet e digjitalizimit, përpilimit të legjislacionit dytësor, pavarësisë së rregullatorit, zgjidhjes së problemeve të interferencave që vijnë jashtë territorit dhe konvergencës së rregullatorëve.

Qëllimi i këtij takimi ishte që të diskutohen çështjet e lartpërmendura të cilat janë brengosëse për KPM-në dhe të gjendet mënyra më e mirë për zgjidhur ato.

#### Takimi i 26-të i EPRA-s në Sofje – Bullgari

Takimi i 26-të i EPRA-s është mbajtur në Sofje – Bullgari nga data 3 deri më 6 tetor të vitit 2007. Në qendër të diskutimit ka qenë çështja lidhur me sfidat e ardhshme rregullative nga vartësitë e reformave rrënjësore të kornizës rregullative të BE-së për

transmetim dhe telekomunikacion. Ndër temat që u diskutuan në këtë konferencë ishte miratimi sa më parë i Direktivës për Mediat Audiovizuale. Temë tjetër ishte edhe analizimi i ndikimit potencial i rishqyrtimit të pakos rregullative të telekomit mbi transmetimin dhe zbërthimin e spektrit të hapësirës komerciale dhe digjitale (*original trading and digital dividend - TDD*).

Sfidat e lartpërmendura janë ilustruar përmes tri grupeve punuese. Grupi i parë rishqyrtoi dispozitat e reja Evropiane lidhur me çështjen e vendosjes së produkteve dhe cila është mundësia që vendet anëtare planifikojnë t'i shndërrojnë atë në nivelin nacional, grupi i dytë diskutoi lidhur me problemet aktuale të transmetimit digjital, me theks të veçantë lidhur me procesin e kalimit të transmetimit në platformën digjitale, si dhe zhvillimin e formave të ndryshme të transmetimit digjital përmes platformave digjitale. Grupi i tretë ekzaminoi se si zhvillimet e reja teknologjike mundësojnë monitorim më efikas dhe me më pak angazhim në kontekstin e proliferimit të kanaleve.

*Konferenca: “Konvergjimi i Mediave – Rregullatorë të Konvergjuar?” Shkup, tetor*

Më 1 dhe 2 tetor 2007, përfaqësues të zyrës së Shefit Ekzekutiv të KPM-së kanë marrë pjesë në konferencën e organizuar nga OSBE – misioni në Maqedoni dhe Këshilli i Evropës lidhur me temën “*Konvergjencia e Mediave – Konvergjencia e Rregullatorëve*”. Në këtë konferencë u diskutua lidhur me shkrirjen e rregullatorëve të telekomunikacioni dhe të transmetimit (mediave) duke u konsideruar kjo si një mundësi për garantimin e pavarësisë financiare dhe ndikimeve politike. Në këtë konferencë kanë marrë pjesë përfaqësues të OSBE-së në Maqedoni, të Asociacionit të Televizioneve Komerciale në Evropë (ACTE), të Këshillit të Evropës, Bashkimi Evropian, APEK Sllovenia, nga OFCOM Britani e Madhe, nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit Bosnjë dhe Hercegovinë etj.

Të gjithë përfaqësuesit që debatuan për këtë temë u shprehën që me konvergjimin e mediave paraqitet edhe nevoja e konvergjimit të rregullatorit. Mirëpo, kjo duhet të ndodh vetëm kur kjo bëhet e nevojë e pashmangshme për industrinë informative. Panelistë të agjencioneve të konvergjuara dhe atyre që veprojnë ndaras, theksuan nevojën e ruajtjes së pavarësisë së rregullatorit të transmetimit. U konkludua që pavarësisht a ka apo nuk ka konvergjencë rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet përmbajtjes së prodhimit informativ dhe komunikativ që i ofrohet konsumatorit.

*Workshopi EPRA – ERG, Capri, tetor 07*

KPM është përfaqësuar edhe në workshopin e përbashkët në mes të Platformës Evropiane të Agjencioneve Rregullative (EPRA) dhe Rrjetit Evropian të rregullatorëve të Telekomit (ERG). Ky ka qenë takimi i parë i përbashkët i rregullatorëve të transmetimit dhe të telekomunikacionit në të cilin për dy ditë është diskutuar konvergjencia e sektorit medial dhe të telekomunikacionit si një paradigmë e re për industrinë e komunikimit, implikimet për rregullim dhe sfidat për të dy grupet e rregullatorëve në skenarin e ri të konvergjencës.

Në të gjitha sesionet kryesore të organizuara përmes 9 paneleve është theksuar me theks të veçantë ruajtja e përmbajtjes programore dhe pavarësia e rregullatorëve, përcaktimi i prioritetëve pa ndërhyrë në kompetencat e njëri-tjetrit në rastet e agjencioneve të

konverguara. Si pjesë e botës që është duke ecur me hapa të mëdhenj drejt globalizimit, Evropa (shtetet anëtare) ka arritur që të përparojë dukshëm në zhvillimin e industrisë së komunikimit duke prezantuar tek konsumatorët media të konverguara, tokësore dhe digjitale dhe së fundi edhe Televizionet Mobile, si një trend që ka nevojë të përkrahet dhe zhvillohet. Nga Komisioni Evropian është thënë që është koha për të vepruar, për të siguruar besueshmëri ligjore dhe për të ndarë frekuenca për t'ju mundësuar shërbimeve të konverguara të fillojnë punën dhe të bëhen ekonomikisht të qëndrueshme. Komisioni dëshiron që Evropa të arrijë mundësinë historike të digjitalizimit që t'i jap një shtytje sektorit të transmetimit dhe atij të telekomit në një situatë që u sjell fitore të dy palëve. Për ta arritur këtë duhet të balancohet rëndësia ekonomike me ato kulturore dhe shoqërore.

Kosova si shtet jo anëtare e Bashkimit Evropian (BE) është dukshëm mbrapa vendeve tjera në zhvillimin e sektorit audiovizuel. Përderisa 19 shtete anëtare janë në rrugë të duhur për ofrimin e Televizioneve Digjitale në rrjetin tokësor dhe atë në High Definition dhe edhe në Mobile TV tek konsumatorët e vet, në Kosovë kemi transmetimin tokësor, që tashmë për disa është bërë mënyrë klasike e transmetimit, dhe transmetimin kabllor si platformë e re, të cilën KPM përfundimisht do ta licencojë në kuartalin e parë dhe të dytë të vitit 2008.

Gjatë kësaj kohe parashihet që të dalin në skenë edhe ofrues të shërbimeve të programeve që do ta pasurojnë sektorin televiziv. Është obligim ligjor i KPM-së që gjatë kësaj kohe të vendos edhe për aktorët kryesorë të cilët do të mbesin në skenë, dmth. do të vendoset që vetëm operatorë kabllorë të ligjshëm të cilët do të veprojnë në harmoni me Rregulloren dhe Ligjin e KPM-së do të lejohen të veprojnë. Veprimtaria e paligjshme e të tjerëve do të ndërpritet. Për këtë KPM ka nevojë për përkrahje nga autoritetet përkatëse për të përdorur mekanizmat adekuatë për të përmbushur obligimin e vet që në treg t'u lejojë qasje të drejtë vetëm operatorëve të licencuar.

## **BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT TJERA**

### *IREX*

Komisioni i Pavarur për Media ka një bashkëpunim të ngushtë me IREX-in, një organizatë ndërkombëtare jo profitabile që vepron në Kosovë e cila, përveç tjerash, ofron mbështetje profesionale në përforcimin e mediave të pavarura. Gjatë vitit 2007, KPM ka formuar grupin punues lidhur me përpilimin e rregullës për rregullimin e operatorëve kabllorë. IREX ka angazhuar një eksperte ndërkombëtare për të mbështetur profesionalisht grupin punues të KPM-së. Më 6 korrik 2007, Këshilli i KPM-së ka miratuar Rregulloren për Distribuim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë.

### *Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE)*

Në veprimtarinë e saj, KPM-ja ka pasur në vazhdimësi një bashkëpunim të ngushtë me Misionin e OSBE-së në Kosovë. OSBE edhe gjatë vitit 2007 ka ofruar ndihmë financiare dhe profesionale. OSBE i ka siguruar KPM-së një Këshilltar dhe ka bartur shpenzimet për anëtarët ndërkombëtar të Këshillit të KPM-së dhe Bordit të Ankesave për Media. OSBE poashtu ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të rekrutuar anëtarin ndërkombëtar të Këshillit për të plotësuar vendin e zbrazët. Në muajin shtator, OSBE ka

mbuluar shpenzimet në vlerë prej 3 500 £ për t'i mundësuar zyrtarit të prokurimit të KPM-së një trajnim dyjavor në Britaninë e Madhe.

Në kuadër të bashkëpunimi, KPM ka arritur të realizojë Projektin “Mbështetje KPM-së” i cili ka filluar të implementohet në muajin tetor. Në fokus të këtij projekti ka qenë përgatitja e procesit për ri-licencim të subjekteve transmetuese në Kosovë. Gjatë implementimit të projektit, janë zhvilluar trajnime, analiza monitoruese dhe janë bërë para përgatitje të duhura për tu përballuar me të gjitha sfidat që mundë të dalin gjatë fazës së ri-licencimit të të gjitha subjekteve transmetuese në Kosovë.

Ky projekt me prioritet për KPM-në është ne vazhdimësi. Objektivat e synuara që të arrihen me ane të këtij projekti, gjatë kësaj faze të ri-licencimit, është që të përdor instrumentet kyçe politike për të garantuar një shumëllojshmëri dhe pluralizëm të tregut medial në Kosovë.

Meqenëse për herë të parë po ndodhë që të bëhet planifikimi nga një rregullator i cili është përgjegjës për menaxhimin e frekuencave, është bërë një strategji e mirë. Ajo bazohet në praktikën me të mira evropiane, gjë që mundëson shmangien e vështirësive që mund të dalin gjatë zbatimit të këtij plani. Në kuadër të projektit të KPM-së për përgatitjen e procesit të ri-licencimit, që është financuar nga OSBE-ja, janë realizuar vetëm tri nga 7 aktivitetet e planifikuara:

- trajnimi i personelit të Divizionit të Monitorimit nga instruktor i Institutit Kosovar për Gazetari dhe Komunikim KIJAC për të bërë monitorim dhe analizë sipas metodave kualitative, kuantitative dhe krahasuese;
- analiza e spektrit frekuencor me angazhim të një eksperti ndërkombëtar, për të vlerësuar pajtueshmërinë e brezit frekuencor analog të Kosovës me konventat ndërkombëtare të përcaktuara nga ITU dhe për të caktuar një pikënisje drejt planifikimit të digjitalizimit ; dhe
- vizita studimore e përfaqësuesve të katër divizioneve në Bosnje dhe Hercegovinë, tek Agjencioni Rregullativ i Telekomunikacionit.

#### Aktiviteti 1 - Trajnimi i Institutit Kosovar për Gazetari dhe Komunikim

Në kuadër të projektit të KPM-së që është financuar nga OSBE është realizuar trajnimi një javor i stafit të monitorimit i cili është udhëhequr nga një ekspert vendor i Institutit Kosovar për Gazetari dhe Komunikim KIJAC.

Trajnimi intensiv një javorë kishte për qëllim avancimin e njohurive të stafit monitorues lidhur me metodologjinë e monitorimit dhe shpjegimin e detajuar të segmenteve të ndërlikuara të monitorimit të mediave elektronike, analizës përmbajtjesore dhe gjuhësore si dhe të politikave editoriale.

#### Aktiviteti 2 - Analiza e spektrit frekuencor analog radio televiziv

Të gjitha frekuencat të dhëna për shfrytëzim nga paraardhësi ligjor i KPM-së , Komisioneri i Përkohshëm për Media janë dhënë për shfrytëzim të përkohshëm. Tani KPM-ja është e obliguar të lëshojë licenca afatgjate për radio dhe televizion. Në mënyrë që i tërë procesi i lëshimit të licencave afatgjate të bëhet në pajtueshmëri me standardet e UNT-së dhe sipas standardeve më të mira Evropiane, KPM-ja është dashur të këtë të dhëna të azhurnuara për situatën e tanishme të planit frekuencor, një analizë e cila do të merret si pikë fillim për procesin e ri-licencimit. Një ekspert për menaxhimin e spektrit

frekuencor është angazhuar të vlerësojë spektrin frekuencor të Kosovës dhe të caktojë parametrat për procesin e ri-licencimit.

### Aktiviteti 3 - Vizita studimore në Sarajevë

Komisioni i Pavarur për Media është në fazën përgatitore për procesin e ri-licencimit të subjekteve transmetuese në Kosovë. Në kuadër të projektit për fazën përgatitore të procesit të ri-licencimit është edhe vizita studimore e stafit të KPM-së në Autoritetin Rregullativ të Komunikimit (“CRA”) në BeH. KPM e ka një bazë të mirë ligjore për të filluar me procesin e ri-licencimit, mirëpo një prej qëllimeve kryesore të vizitës studimore në CRA ka qenë edhe marrja e përvojës së tyre të gjatë realizimit të procesit të ri-licencimit të subjekteve transmetuese në BeH si dhe njohja nga afër e vështirësive dhe e gabimeve të mundshme që atyre i janë paraqitur gjatë këtij procesi.

Arsyeja e përcaktimit që vizita studimore të bëhet në BeH qëndron për faktin se baza ligjore e CRA-së dhe ajo e KPM-së kanë ngjashmëri, në shumë aspekte. Prandaj gjatë shkëmbimit të përvojave mes stafit të KPM-së dhe CRA-së lidhur me realizimin e procesit të ri-licencimit do të krijohet mundësia për KPM-në që të rishqyrtojë akte nënligjore me qëllim të parandalimit dhe evitimit problemeve dhe pengesave që do të mund të paraqiten gjatë procesit të ri-licencimit, ashtu siç janë paraqitur në CRA, kështu që të mos përsëriten të njëjtat edhe gjatë procesit të ri-licencimit në Kosovë.

